



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/ 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 22.09.2021

Për: Operatorin Ekonomik “Adel Co” sh.p.k me NIPT L22117021M.

Adresa: Rruga Muhamet Gjollesha, tek Zogu i Zi, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr. nr.9, datë 29.04.2021 me objekt: **“Prodhimi i emisioneve të pullës për vitin 2021”** me fond limit 11,405,250 (Njëmbëdhjetë milion e katërqind e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH., vënë në dispozicion nga të ardhurat e vetë Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a. Procedurë e hapur në mënyrë elektronike, e cila u zhvillua më datë **07.07.2021, ora 10.00.** [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-94383-04-30-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Prodhimi i emisioneve të pullës për vitin 2021”

Fondi Limit: 11,405,250 (Njëmbëdhjetë milion e katërqind e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 07.07.2021, ora 10.00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 10.05.2021 [Numri J 70

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me ofertën ekonomike si më poshtë vijon:

1. Operatori Ekonomik **“Dynamic X”** sh.p.k me NIPT L42306022T me vlerë të ofertës ekonomike 7.947.750 (shtatë milion e nëntëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

2. Operatori Ekonomik “**Kristalina -KH**” sh.p.k me NIPT K11501002D me vlerë të ofertës ekonomike 9.320.500 (nëntë milion e treqind e njëzetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik “**ALBDESIGN PSP**” me NIPT L5181905Q me vlerë të ofertës ekonomike 9.442.250 (nëntë milion e katërqind e dyzetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “**Adel CO**” sh.p.k. me NIPT L22117021M me vlerë të ofertës ekonomike 10.928.250 (dhjetë milion e nëntëqind e njëzetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

I. Operatori ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k., me NUIS L42306022T

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush kriteret e kualifikimit 2.3.13. ku është përcaktuar se “*Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letër pulle postare të bllokut 1/a sipas Skedës Teknike, format 80 x 60 mm (në brendësi i birosur 40 x 30 mm), pa foto*” dhe të kriterit të kualifikimit 2.3.11 ku përcaktohet se: “*Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle.....*”

- Nuk përmbush kriterin e kualifikimit “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”, operatori ekonomik nuk ka vërtetuar shlyerjen e detyrimit për muajin Prill 2021.

- Nuk përmbush kriterin e kualifikimit 2.3.10., “*Operatori Ekonomik duhet të disponojë makineri birosje (perforimi) për pullën me krehrat përkatës, të vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose kontratë qiraje. Në rastin e marrjes me qira duhet të shoqërohet dhe me dokumentacionin e pronësisë së qiradhenësit*”.

- Nuk përmbush kriterin e kualifikimit 2.3.6., ku përcaktohet se “*Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14298 për menaxhimin e sigurisë së procesit të shtypit të prodhimit të mallrave me elementë sigurie ose ekuivalente. (Certifikata duhet të jete e leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë)*”.

II. Operatori ekonomik “Kristalina.KH” sh.p.k. me NUIS K11501002D

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Kampioni i dorëzuar nuk është në përputhje me specifikimet teknike dhe kriterin e kualifikimit 2.3.11 . Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave si më poshtë:

- a) **Pesha totale e letrës me gjithë elementët e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m2 deri në 105 gr/m2 maksimumi.**
- b) **Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.**
- c) **Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.**
- d) **Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj nga kompania prodhuese e letrës.**
- e) **Kampioni të jetë në përmasa jo më të vogël së formati A3.**

Kampioni i paraqitur dorazi duhet të dorëzohet edhe në rrugë elektronike së bashku me dokumentacionin tjetër pjesë të ofertes.

- Nuk përmbush kriterin e kualifikimit 2.3.5 “*Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001 për cilësinë e prodhimit të mallrave me elementë sigurie ose ekuivalente. (Certifikata duhet të jete e leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë)*”

Nuk përmbush kriterin e kualifikimit 2.3.6 “*Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 14298 për menaxhimin e sigurisë së procesit të shtypit të prodhimit të mallrave me elementë sigurie ose ekuivalente. (Certifikata duhet të jete e leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë)*”

III. Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k., me NUIS L51819005Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme

- Kampioni i dorëzuar nuk është në përputhje me specifikimet teknike dhe kriterin e kualifikimit 2.3.11. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave si më poshtë:

- f) **Pesha totale e letrës me gjithë elementët e saj përfshirë ngjitësin, fijet fosforeshente dhe llakun të jetë minimumi 95 gr/m2 deri në 105 gr/m2 maksimumi.**
- g) **Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.**
- h) **Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.**
- i) **Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj nga kompania prodhuese e letrës.**
- j) **Kampioni të jetë në përmasa jo më të vogël së formati A3.**

Kampioni i paraqitur dorazi duhet të dorëzohet edhe në rrugë elektronike së bashku me dokumentacionin tjetër pjesë të ofertes .

- Nuk përmbush kriterin e kualifikimit 2.3.8. “*Operatori Ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinimin e letrës dhe për produktet e gatshme të siguruara me*

kamera sigurie. Për këtë duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë shitblerje ose kontratë dhurimi ose kontratë qiraje të ambientit, shoqëruar me dokumentacion pronësie të qiradhenësit.”,

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**Adel CO**” Sh.p.k Nipt L22117021M, me adresë: Rruga “Muhamet Gjollesha, tek Zogu i Zi, Tiranë, se Oferta Ekonomike me vlerë 10.928.250 (dhjetë milion e nëntëqind e njëzetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Posta Shqiptare Sh.a. me adresë: Rr.: “Reshit Collaku”, Nr.4, Tiranë, Drejtoria Juridike, Sektori i Prokurimeve, kati II [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] kopjet e sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 83, 97 dhe 98 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **14.09.2021**.

Ankesa: ka ose jo: Lidhur me DST-në, me datë 14.05.2021 kemi patur ankesë nga operatori ekonomik “**Albdesign**” sh.p.k.,

Brenda afateve ligjore, autoriteti kontraktor ka shqyrtuar ankesën duke i kthyer përgjigje operatorit ankimues me shkresën Nr. **938/10** prot., datë 18.05.2021.

Me shkresën Nr.938/11 prot., datë 19.05.2021 me lëndë: Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “**Prodhimi i emisioneve të pullës për vitin 2021**” i është dërguar informacion KPP-së.

KPP me vendimin Nr.316/2021 datë 25.06.2021, ka vlerësuar të drejta veprimet e AK_së duke urdhëruar me vijimin e procedurës.

Autoriteti Kontraktor në zbatim të Vendimit Nr.316/2021 datë 25.06.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik ka bërë modifikimet përkatëse si dhe ka vijuar me zhvillimin e procedurës.

Me datë **07.07.2021, ora 10.00** është bërë mbyllja e dorëzimit të ofertave në SPE.

Lidhur me vlerësimin e ofertave Brenda afateve ligjore, nuk kemi patur ankesa pranë Autoritetit Kontraktor nga operatorët ekonomik ofertues.

Referuar urdhërit të prokurimit nr.9 datë 29.04.2021 kjo procedurë është hedhur në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Agjencia e Prokurimit Publik, me shkresën nr.3588 prot., datë 26.05.2021 “Njoftim”, paragrafi i parafundit në faqen nr. 3, ka këshilluar autoritet kontraktore se: **“Procedurat e prokurimit të nisura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi (V.K.M. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike”) vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato janë shpallur.”**

Referuar sa më sipër, Njoftimi i Fituesit për këtë procedurë prokurimi, është hedhur pas përfundimit të afateve ankimit të parashikuar në nenin 78, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Hipokrat Biba